



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 68

Prishtinë, më 1 qershor 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Teuta Hadri, Qamile Morina, Flora Brovina dhe Vezira Emrush.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Zyrës së Komisioneve të Kuvendit, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit, Liridon Selmani – KDI dhe Virtyt Ibrahimaga – ekspert.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 18. 05. 2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për punën, para miratimit në parim;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për grevat;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale;
6. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 18. 05. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për punën, para miratimit në parim

Sadik Idriz - Projektligji për punën do të shqyrtohet në parim në Kuvend në mbledhjen e radhës. Ky Projektligj prapë ka ardhur në Kuvend, pas herës së kaluar që është kthyer për ripunim. Tani i kemi disa restriksione në disa nene që të mos ketë shumë implikime buxhetore. Të shohim se çfarë mund të bëjmë që ky Projektligj të miratohet dhe të zbatohet. E mbështes miratimin e tij në parim, sepse është ligj i rëndësishëm, me gjithë disa rezerva që i kam. Komisioni do të organizojë edhe dëgjim publik dhe bashkërisht do të bëjmë përpjekje që ligji të jetë sa më i mirë.

Gjylnaze Sylja – Tha se fillimisht duhet t'i kërkojmë nga ministri i MPMS-së dy sqarime, një lidhur me koston buxhetore të ligjit, sepse ligji nuk jep sqarime lidhur me koston buxhetore. Çështja tjetër që kërkon sqarime është lidhur me marrëveshjen që ka MPMS-ja me FMN-në. A ka marrëveshje të tillë dhe çfarë përmban ajo? Përsëri çështja më e rëndësishme mbetet ajo e lehonisë. Me rregulloret e tashme, pushimi i lehonisë është 3 + 3. Tre muaj paguan punëdhënësi dhe 3 muaj Qeveria. Projektligji, që ka ardhur është më diskriminues se Rregullorja, sepse pushimin e lehonisë e parasheh 3 + 1 muaj shtesë. Këto janë tri çështje për të cilat duhet të kërkojmë sqarime në seancë nga ministri.

Rita Hajzeraj – Pajtohet që Projektligji që ka ardhur është më diskriminues se Rregullorja në fuqi. Kërkesat herën e kaluar kanë qenë që pushimi i lehonisë të jetë 6 + 3, pra të jetë 9 muaj me pagesë. Tani është reduktuar në 3 + 1, që është shumë diskriminues. Gjithashtu të gjitha institucionet parashkollëre i pranojnë fëmijët vetëm pas moshës 1-vjeçare. Si e parasheh këtë çështje kjo Ministri? Ku t'i lënë fëmijët nga mosha 4 muaj deri në një vit nënat që punojnë? Ose duhet të ndryshohet ligji i institucioneve parashkollëre, ose në këtë ligj të parashihet pushimi i lehonisë 6 + 3, pra 9 muaj. Po ashtu duhet të kërkojmë sqarime nga ministri lidhur me implikimet buxhetore të këtij ligji. Ne mund ta pranojmë në parim ligjin për shkak të rëndësisë së tij, por nëse nuk ka mundësi të ndryshohet pushimi i lehonisë, nuk pajtohem që ta miratojmë as në parim.

Teuta Hadri – Nëse Komisioni Funkcional pajtohet për një çështje, do të pajtohet edhe seanca. Problemi më i madh i këtij ligji, edhe më herët ka qenë pushimi i lehonisë, sepse nuk ka pasur mbulesë buxhetore. Edhe më herët insistimi i deputetëve të Kuvendit ka qenë që pushimi i lehonisë të jetë një vit. Pajtohem me propozimin që ligjin duhet ta mbështesim në parim, pastaj me amendamente ta rregullojmë pushimin e lehonisë. Ndoshta mund ta bëjmë edhe një propozim shtesë që nënat me më shumë se tre fëmijë, të kenë pushim të lehonisë një vit.

Qamile Morina – Tha se ligji i punës është ligj bazik. Arsyeja kryesore e mosmiratimit të këtij ligji është kostoja buxhetore. Mendoj se asnjëherë nuk është bërë një analizë e mirë e ligjit dhe e koston buxhetore. Edhe tani nuk ka analizë të mirëfilltë buxhetore. Ka kosto tejet të paqartë. Ky është një ligj edhe më i dobët se Rregullorja aktuale në fuqi. Ne duhet ta mbështesim në parim, për shkak të rëndësisë që ka ky ligj, por duhet ta mbështesim me këto vërejtje që i kemi dhe të kërkojmë sqarime në Kuvend nga ministri lidhur me këto çështje.

Vezira Emrush – Ky ligj nuk është i mirë dhe i ka disa të meta. Duhet t'i ketë edhe sanksionet për punëdhënësit. E drejta themelore e njeriut është e drejta e punës. Nëse nuk e stimulojmë punësimin e të rinjve nëpërmjet ligjit të punës, nuk do të ketë punësim. Ky ligj është kopje e ligjeve të shteteve të tjera. Duhet të angazhohemi t'i përkrahim femrat në

pushimin e lehonisë. Do të angazhohem më shumë që ta jap kontributin tim në përmirësimin e këtij ligji.

Nurishahe Hulaj – Komisioni duhet ta marrë një qëndrim të përbashkët, sepse ka kohë që e kemi kërkuar këtë Projektligj. Është mirë që më në fund ka ardhur. Në një tryezë të organizuar për këtë ligj, përqendrimi kryesor ka qenë në nenin 48, pra te rregullimi i pushimit të lehonisë, për të cilin ka pasur reagime të mëdha. E dimë se buxheti i Kosovës është shumë i varfër, por patjetër duhet të kontribuojmë në këtë çështje. Propozimi im është që pushimi i lehonisë të jetë 12 muaj. Nëse nuk është e mundur, le të jetë 6 muaj me pagesë dhe 6 muaj pa pagesë, por me të drejtë kthimi në vendin e punës

Rita Hajzeraj – Edhe më parë Projektligji i pushimit të lehonisë është kthyer për shkak të implikimeve buxhetore. Përsëri erdhi me të njëjtat pengesa. Nëse nuk marrim përgjigje nga ministri për pushimin e lehonisë, nuk do të duhej ta miratonim as në lexim të parë.

Sadik Idriz – Ndoshta varianti më i mirë do të ishte 6 muaj me pagesë dhe 6 muaj pa pagesë. Ta dëgjojmë përgjigjen e ministrit në seancë, pastaj Komisioni me amendamente le ta ndryshojë pushimin e lehonisë.

Për këtë Projektligj do të organizojmë edhe dëgjim publik dhe do ta vizitojmë edhe ndonjë shtet në mënyrë që ta bëjmë ligjin sa më të mirë.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që Projektligji të përkrahet në parim, me kërkesën që ministri i MPMS-së në seancë të japë sqarime lidhur me zgjatjen e pushimit të lehonisë dhe për implikimet buxhetore të Projektligjit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për grevat

Teuta Hadri – Grupi i punës, në përbërjen që e ka votuar Komisioni, në bashkëpunim me BSPK-në, i ka propozuar këto amendamente, të cilat i paraqet para Komisionit. I presim edhe komentet tuaja në mënyrë që ligji të jetë sa më i mirë.

Amendamenti 1

Neni 3, riformulohet:

Organizimi i grevës në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Policinë e Kosovës, në Shërbimet e Zjarrfikësve, në Shërbimet Emergjente dhe në organet me interes të veçantë për Republikën e Kosovës, rregullohet me ligje të veçanta të këtyre organeve.

Amendamenti 2

Neni 5, paragrafi 1, riformulohet:

1. Organizatat sindikale ose gjysma e të punësuarve e një organizate të caktuar punuese, ku nuk ka organizim sindikal, kanë të drejtë të organizojnë greva, për t'i mbrojtur interesat e tyre ekonomike, sociale dhe profesionale.

Amendamenti 3

Në nenin 10, në paragrafin 1, pas nënparagrafit 1.3, shtohet paragrafi i ri, si vijon:

1.4. Tubimit të të punësuarve jashtë ambienteve të punës dhe në hapësira të tjera.

Amendamenti 4

Në nenin 13, të hiqen paragrafët 2 dhe 3.

Amendamenti 5

Në nenin 17, paragrafi 1, riformulohet:

1. Organizimi i grevës në veprimtaritë me interes të veçantë publik dhe në veprimtaritë në të cilat ndërprerja e punës, bazuar në natyrën e punës, mund ta rrezikojë jetën ose shëndetin e njerëzve, ose të shkaktojë dëme me pasoja të mëdha, mund të realizohet nëse plotësohen kushtet e veçanta të përcaktuara me këtë ligj. Si kusht i veçantë është të sigurohet minimumi i procesit të punës dhe të prodhimit, që të sigurohen jeta dhe shëndeti i njerëzve, ose të mos shkaktohen dëme me pasoja të mëdha.

Amendamenti 6

Në nenin 17, në paragrafin 2, pas nënparagrafit 2.8, shtohet një nënparagraf i ri, si vijon:

2.9. Shërbimet sanitare higjienike.

Amendamenti 7

Në nenin 25, në paragrafin 1, pas fjalëve: “person juridik”, shtohen fjalët: “ose personi përgjegjës i personit juridik”.

Amendamenti 8

Në nenin 25, pas paragrafit 1, shtohet një paragraf i ri, si vijon:

2. Me gjobë prej 500 deri 1000 €, do të dënohet për kundërvajtje, sindikata ose këshilli grevist nëse:

2.1 Gjatë grevës refuzon të bashkëpunojë me organin punëdrejtues në organizatë, për ta siguruar ushtrimin e minimumit të procesit të punës, që e siguron sigurinë e njerëzve dhe të pasurisë, që është kusht i pazëvendësueshëm i jetës dhe i punës së qytetarëve.

2.2 Vepron në kundërshtim me nenin 7.

2.3 Vepron në kundërshtim me nenin 15.

Amendamenti 9

Në nenin 25, paragrafi 2, bëhet paragraf 3 dhe riformulohet, si vijon:

3. Me gjobë prej 50 deri 300 € do të dënohet për kundërvajtje, punëtori i cili gjatë grevës:

3.1. Refuzon të bashkëpunojë me organin punëdrejtues në organizatë, për ta siguruar ushtrimin e minimumit të procesit të punës, që e siguron sigurinë e njerëzve dhe të pasurisë, që është kusht i pazëvendësueshëm i jetës dhe i punës së qytetarëve.

3.2. Vepron në kundërshtim me nenin 7.

3.3 Vepron në kundërshtim me nenin 15.

Paragrafi 5 i nenit 25 bëhet paragraf 4 .

Komisioni njëzëri i votoi amendamentet e propozuara nga grupi i punës dhe i procedoi në komisionet kryesore.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për produktet dhe pajisje medicinale

Sadik Idriz - Ky Projektligj ka një kohë të gjatë që është duke u shqyrtuar nga grupi i punës dhe ka shumë çështje për t'u diskutuar.

Fjalën ia dha udhëheqëses së grupit të punës, Rita Hajzeraj .

Rita Hajzeraj – Grupi i punës dhe eksperti i angazhuar për këtë Projektligj kanë punuar shumë, por Projektligji ka nevojë për shumë ndryshime. E kemi edhe një kërkesë gojore nga Ministria e Shëndetësisë për kalimin e Inspektoratit nga Ministria e Shëndetësisë në AKPM. Në këtë takim po diskutojmë për propozimet e ekspertit Virtyt Ibrahimaga, ndërsa në mbledhjen e radhës do t'i votojmë amendamentet një nga një.

Virtyt Ibrahimaga – Kam punuar në disa nene, në të cilat sipas propozimeve tuaja i kam amendamentuar disa çështje më kryesore. Nenet, të cilat i kam propozuar të amendamentohen, janë: neni 4, që përkufizohet çfarë është Agjencia e Kosovës për Produkte, neni 5, organet e AKPM-së, neni 6, kompetencat e AKPM-së, neni 7, zgjedhja e drejtorit të AKPM-së, neni 8, Komisioni për Vlerësimin e Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale (KVPPM), neni 9, Bordi i Ankesave, neni 10, Komisioni Etik, neni 11, Laboratori Kombëtar për Produkte dhe Pajisje Medicinal (LKPPM).

Pas diskutimeve anëtarët e Komisionit u pajtuan që në mbledhjen e radhës të votohen amendamentet një nga një .

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz